



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.40/2016

Prishtinë, më 30 shtator 2016,

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Bajram Zejnullahu, zëvendëskryesues i Bordit të AKP-së, Avni Jashari-zëvendësdrejtor menaxhues i likuidimit në AKP, Ukë Gashi-ZPRK, Drita Vitia-KosovaPress, Agnesa Haxhiu-KDI, Eugen Cakolli-KDI.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, i hapi punimet e mbledhjes, me këtë

Rend të ditës:

- 1. Shqyrtimi i kërkesës së ish- punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit. Të ftuar: Bordi i AKP-së;**
- 2. Të ndryshme.**

1. Shqyrtimi i kërkesës së ish- punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit. Të ftuar: Bordi i AKP-së

Lirije Kajtazi, fillimisht tha se Bordi i AKP-së, i është përgjigjur ftesës së Komisionit për pjesëmarrje në këtë mbledhje, por edhe për dërgimin e shkresave sqaruese, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së ish- punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit dhe më pas, ia dha fjalën përfaqësuesve të AKP-së.

Avni Jashari, tha se për lëndën e ish- punëtorëve të ndërmarrjes “Sharr Salonit”, procesi i ankesave është ende duke u trajtuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe nuk kemi informata se kur do të merret vendimi final.

Shuma e fondeve që ka rrjedhur nga procesi i shitjes së katër ndërmarrjeve shoqërore është më e ulët se sa shumat e kërkesave kreditore, për këtë arsye pa u shqyrtuar vendimet e ankesave të kreditorëve dhe punëtorëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, AKP-ja e ka të pamundur ligjërisht të bëjë shpërndarjen e tërësishme apo të pjesshme të pagave, të cilat janë aprovuar për punëtorët e kësaj ndërmarrje, po ashtu edhe për kreditorët tjerë.

Ligji e përcakton që vetëm në rastet kur ka fonde të mjaftueshme më shumë se që ka numër të ankesave, mund të bëjmë shpërndarjen e pjesshme për pagat apo për kërkesa të tjera kreditore. Kjo i referohet nenit 41, të shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nenad Rashiq, në fjalën e tij u interesua të dijë se numri prej 3282 kërkesave të refuzuara, janë si pasojë e mungesës së fondeve apo për shkak të mosplotësimit të kushteve.

Avni Jashari, tha se kërkesat kreditore të cilat janë refuzuar, janë për shkak se nuk i kanë plotësuar kërkesat ligjore dhe autoriteti i likuidimit i cili emërohet prej Bordit të Drejtorëve të AKP-së, sipas Ligjit e vlerëson se një kreditori apo një punëtori, të cilët i kërkojnë fonde ndërmarrjes dhe nuk i plotësojnë kërkesat ligjore për tu aprovuar, kjo bie në atë fushë ku nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për tu konsideruar të vlefshme, këto raste kanë të drejtë ankese në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Teuta Haxhiu, insistoi që mundësisht, të përmenden pak më në detaje se cilat janë ato kërkesa ligjore që këta punëtorë të kësaj ndërmarrje nuk i kanë plotësuar.

Avni Jashari, theksoi se nëse flasim për kërkesa kreditore, që janë furnitorë të ndryshëm, një furnitorë që të konsiderohet i vlefshëm, kërkesa e tyre duhet të ketë një kontratë të furnizimit me ndërmarrjen shoqërore, duhet të ketë faturën, fletëdërgesën si dhe pranimi prej ndërmarrjes shoqërore dhe nëse i plotëson këto kritere atëherë autoriteti i likuidimit e vendos aprovimin.

Jashari tha se janë afatet ligjore kur mund të parashkruhet një kërkesë kreditore, ndërsa në rastin e punëtorëve, nëse kanë qenë në listën e pagave dhe i kanë kryer shërbimet por nuk ju kanë paguar pagat atyre, atëherë normalisht duhet t’ju paguhen, mirëpo, nëse ne kemi dëshmi se atyre punëtorëve ju kanë paguar pagat dhe kërkojnë pagesë të dyfishtë atëherë kërkesat ju refuzohen.

Mytaher Haskuka, theksoi se punëtorët të cilët kanë punuar në këtë ndërmarrje dhe kanë probleme shëndetësore për shkak të azbestit, ku 100 prej tyre janë diagnostifikuar me sëmundje profesionale ende nuk i kanë marrë pagesat e tyre edhe pse janë viktimë e punës. Sa zgjatë procedura e shqyrtimit të këtyre lëndëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme?

Avni Jashari, shtoi se sipas raporteve vjetore që i kemi parë, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, diku prej 1.500 deri në 1.600 vendime finale i lëshon kjo Dhomë, përafërsisht tani janë rreth 15.000 kërkesa kreditore, të cilat janë në shqyrtim e sipër.

Salihe Mustafa, vlerësoi gatishmërinë e Bordit të AKP-së, për ti ndihmuar kësaj kategorie, duke pasur parasysh se këta njerëz për shkak të specifikave që kanë, dhe pyeti se a ka ndonjë mundësi ligjore që të tejkalohet kjo situatë.

A keni mundësi për përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin e këtyre kërkesave, për shkak të rrezikshmërisë së shëndetit të këtyre punëtorëve, nga materiet e dëmshme me të cilat janë ballafaquar gjatë punës?

Avni Jashari, theksoi se është çështje e Komisionit FunkSIONAL se si do të reagojë lidhur me këtë çështje.

Lirije Kajtazi, pyeti se a është vërejtur nga ana e juaj se këto vonesa që po ndodhin janë pikërisht për shkak të numrit të vogël të gjykatësve në atë dhomë.

Avni Jashari, tha se sipas asaj që ne kemi kuptuar nga takimet me autoritetet e kësaj gjykate, janë dy arsye për këto vonesa; si numri i vogël i gjyqtarëve dhe numri i vogël i stafit administrativ që mbështet gjyqtarët.

Mexhide Mjaku-Topalli, në fjalën e saj u fokusua në çështjen se nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, kthen përgjigjeje se këta kreditorë kanë të drejtë në përfitimin e mjeteve, a do të ju përgjigjeni ju në përmbushjen e atyre obligimeve, kur e dimë se një gjë e tillë nuk është respektuar në rastin e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, kur gjykata ka vendos në favor të tyre dhe ata po enden rrugëve duke kërkuar realizimin e të drejtës së tyre.

Avni Jashari, duke u përgjigjur në këtë çështje, theksoi se Ligji e përcakton se të drejtat dhe obligimet e një ndërmarrje shoqërore nuk mund t'i barten ndërmarrjes tjetër, për këtë arsye fondet e ndërmarrjeve mbahen ndaras.

Ai paraqiti edhe të dhëna tjera lidhur me këtë çështje.

Teuta Haxhiu, ndër tjera shtroi çështjen e ndërmarrjes së veprimeve më konkrete dhe kërkoi që mos të zvarritet kjo çështje, me qëllim të shqyrtimit me prioritet nga ana e Gjykatës.

Ajo kërkoi që me një rekomandim të kërkohet një gjë e tillë dhe të merret përgjigja në afatin sa më të shpejt kohor.

Lirije Kajtazi, tha se do të analizojnë rrugën më të qëlluar për të vepruar, lidhur me këtë çështje, në mënyrë që të arrihet deri tek rezultati i pretenduar, me qëllim të përmbushjes së kërkesave të punëtorëve në fjalë.

Mytaher Haskuka, propozoi që të kërkohet nga Qeveria që të veprojë në rritjen e numrit të gjyqtarëve si dhe të stafit civil në këtë Gjykatë.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës, Lirije Kajtazi, kryetare, konstatoi se do të ketë së shpejti një konsultë edhe me Avokatin e Popullit, dhe më pas do të njoftojë Komisionin për hapat e mëtejshëm.

3. Të ndryshme.

Lirije Kajtazi, i njoftoi anëtarët e Komisionit, lidhur me ankesat e qytetarëve për çështje infrastrukturore, në rastin e fshatit Hade e Re, ku sipas përgjigjes nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, realizimi i projektit të kanalizimit është afër finalizimit.

Në lidhje me mbajtjen e një dëgjimi publik për të identifikuar shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të dala nga Raporti i Monitorimit të Ligjit për Personat e Verbër, u vendos që kryetarja në bashkërendim me administratën e Komisionit, në ndërkohë, të caktojë datën e mbajtjes.

Po ashtu, kryetarja, njoftoi se do të bëjnë një ftesë për ministrin Arban Abrashi, për të kërkuar informacione rreth zbatimit të Ligjit për Personat e Zhdukur, me qëllim të identifikimit të gjendjes para se të merret nisma për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji.

Në lidhje me organizimin dhe mbështetjen e punëtorisë për shqyrtimin dhe formulimin e amendamenteve për Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, ajo theksoi se punësoria do të mbështetet nga partnerët mbështetës të Komisionit, të cilët kanë shprehur gatishmërinë për këtë çështje.

Më pas, kryetarja shprehu pakënaqësinë e saj në emër të Komisionit, për arrestimin nga pushteti i Serbisë, të komandantit të policisë së regjionit të Mitrovicës z. Nehat Thaçi. Ajo deklaroi se mbështetë çdo formë të reagimit lidhur me këtë çështje, për të cilën vendos Komisioni FunkSIONAL.

Në vazhdim, mbledhjen e kryesoi znj. Salihe Mustafa, nënkryetare.

Lidhur me arrestimin nga pushteti i Serbisë, të komandantit të policisë së regjionit të Mitrovicës z. Nehat Thaçi, diskutuan deputetët Teuta Haxhiu, Salihe Mustafa dhe Mexhide Mjaku-Topalli.

Nga diskutimet e deputetëve të lartpërmendur, doli konstatimi se Komisioni FunkSIONAL duhet të shpreh qëndrimin e vet përmes një Reagimi.

Deputeti Nenad Rashiq, nuk e mbështeti qëndrimin e lartpërmendur.

Diskutimet e deputetëve lidhur me këtë çështje ekzistojnë të plota në arkivat elektronike të administratës së Komisionit FunkSIONAL.

Në fund, kryesuesja Salihe Mustafa, konstatoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në lidhje me arrestimin e z. Nehat Thaçi, drejtor i Policisë Rajonale në Mitrovicë, nxori këtë:

R E A G I M

Ne, anëtarët e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me shqetësim morëm lajmin për arrestimin arbitrar dhe kundërligjor të z. Nehat Thaçi, drejtor i Policisë Rajonale në Mitrovicë.

Serbia, në vazhdimësi po ndjek metodat më të mbrapshta të arrestimit dhe frikësimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, gjithnjë sipas akuzave false dhe të pabazuara.

Republika e Kosovës në vazhdimësi, përmes akteve të shumta ligjore por edhe përmes procesit të bisedimeve në Bruksel, po e jep kontributin e vet në funksion të fqinjësisë së mirë dhe të avancimit të bashkëpunimit rajonal, ndërsa në anën tjetër, shteti serb, assesi të mësojë nga qasja dhe nga praktikat e fqinjësisë së mirë, që në çdo fazë, promovon Republika e Kosovës dhe institucionet e saj, në partneritet me SHBA-në dhe BE-në.

Të mos harrojmë se lëvizja e lirë e njerëzve është njëra nga komponentët më fundamentale të parimeve të civilizimit evropian dhe në përmasa globale.

Kërkojmë nga mekanizmat ndërkombëtarë, që të bëjnë presion mbi shtetin serb, në mënyrë që z. Nehat Thaçi të lirohet menjëherë dhe pa asnjë kusht.

Reagimi të dërgohet për publikim në medie.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14:00

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit

